



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**

---

Nr. 34/32 Prot.

Tiranë, më 25.10.2016

**Drejtuar :**    **MINISTRISË SË FINANCAVE**  
                  **DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT**  
                  **DREJTORIA E MONITORIMIT DHE MENAXHIMIT TË BUXHETIT**

**TIRANË**

**Lënda:**       **Mbi raportin e monitorimit të buxhetit për periudhën Janar-Shtator të vitit 2016.**

Në mbështetje të Ligjit nr. 147/2015, datë 17.12.2015 òPër buxhetin e vitit 2016ò, dhe në vijim të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 2, datë 06.02.2012, òProcedurat standarde të zbatimit të buxhetitò, udhëzimit plotësues të Ministrit të Financave nr. 1, datë 15.01.2016 òPër zbatimin e buxhetit të vitit 2016ò, si dhe Aktit Normativ nr. 1, datë 29.07.2016 òPër disa ndryshime në Ligjin nr. 147/2015, òPër buxhetin e vitit 2016ò për periudhën janar-shtator të vitit 2016, performanca e produkteve të buxhetit, paraqitet si më poshtë:

**Programi 01120 “Veprimtari audituese e Kontrolli të Lartë të Shtetit ”**

Buxheti i akorduar për programin òVeprimtari auditueses e KLSH-sëò, ka në bazë të tij Deklaratën e Politikës të hartuar gjatë procesit të PBA 2016-2018 dhe është në funksion të realizimit të politikës së përcaktuar në DPP. Politika buxhetore e këtij programi, ka si qëllim, përmbushjen me cilësi të lartë dhe në kohë të detyrimeve kushtetueses dhe ligjore, të objektivave si dhe prioriteteve të institucionit të parashikuar në Planin e Zhvillimit Strategjik 2013-2017 të ripunuar, duke konsideruar kërkesat e organizmave ndërkombëtarë të auditimit dhe të BE-së të përcaktuara në MSA-në e Shqipëri-BE dhe të monitoruara nga DG Budget, në kuadrin e Integritimit Europian.

**“Raporti i Shpenzimeve Faktike të Programit sipas Artikujve për 9/mujorin 2016”**

Në zbatim të Ligjit 147/2015, òPër buxhetin e vitit 2016ò, dhe shkresës së Ministrisë së Financave nr. 17761/124, datë 11.01.2016 òMbi detajimin e buxhetit të vitit 2016ò, si dhe Aktit Normativ nr. 1, datë 29.07.2016 òPër dida ndryshime ne ligjin nr. 147/2015, òPër buxhetin e vitit 2016ò, është bërë miratimi i çeljes me ndryshimet e fondeve buxhetore për vitin 2016 për institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Fondet e alokuara për funksionimin e aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, sipas zërave për vitin 2016 paraqiten si më poshtë:

### **1- Shpenzime personeli. Llogaria 600-601**

Fondi i alokuar nga buxheti i shtetit për vitin 2016 për zërin Paga dhe Sigurime është 261,000 mijë lekë, nga të cilat:

-Pagat nga 229,000 mijë lekë të planit vjetor janë shpenzuar në vlerën 163,042 mijë lekë

-Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore nga 32,000 mijë lekë të planit vjetor janë shpenzuar në vlerën 23,795 mijë lekë.

Shuma e shpenzuar në zërin Shpenzime Personeli, përfshin pagat e punonjësve të KLSH-së dhe të ekspertëve të jashtëm të përkohshëm të kontaktuar dhe paguar komform shkresave dhe kontratave të nënshkuara me ta.

### **2- Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera. Llogaria 602**

Fond i alokuar nga buxheti i shtetit për vitin 2016 është 87,000 mijë lekë, ku fond i planifikuar për Shpenzime për Mallra dhe Shërbime, për periudhën Janar- Shtator 2016 është shpenzuar në masën 45,446 mijë lekë. Nga analiza faktoriale rezulton se një pjesë e procedurave të prokurimit janë në proces, një pjesë e diferencës janë fatura të pa mbërritura në institucion si dhe disa procedura prokurimi kanë rezultuar me diferencë. Me këtë zë shpenzimesh janë përballuar gjithashtu edhe mbulimi i nevojave administrative të shpenzimeve si shpenzime për drita, ujë, telefon etj. Në këtë artikull një pjesë të konsiderueshme e zënë shpenzimet për trajnime jashtë dhe brenda vendit dhe për dieta në funksion të veprimtarisë audituese. Ngritja e Kapaciteteve është një nga objektivat Strategjikë të KLSH që parashikohet në Strategjinë e Zhvillimit 2013 -2017 e ripunuar 2015-2017. Për arritjen e këtij objekti, KLSH përgjatë periudhës 9 muajore janar-shtator 2016, ka marrë pjesë në mënyrë aktive në shume aktivitete trajnimi, takime dhe grupe pune, konferenca dhe simpoziume, të cilat kanë synuar ndërtimin e kapaciteteve , rritjen e aftësive dhe njohurive profesionale të audituesve në funksion të rritjes së cilësisë së auditimit. Organizimi dhe pjesëmarrja në këto aktivitete janë shoqëruar me kostot përkatëse duke u fokusuar në menaxhim sa më të kujdesshëm dhe përdorim sa më me efektivitet.

Në frymën e standardeve të INTOSAI, konkretisht ISSAI 20, për transparencën dhe llogaridhënien, KLSH gjatë vitit 2016, për periudhën janar-shtator 2016, ka realizuar 8 botime.

1. Revista e Auditimit Publik nr. 12.
2. KLSH Analiza Vjetore, 2015.
3. Audituesit e KLSH-së në Shtypin e Përditshëm. Volumi V.
4. Audituesit e KLSH-së në Shtypin e Përditshëm. Volumi VI.
5. Standartet Ndërkombëtare të Auditimit.
6. Direktivat e BE-së mbi Prokurimin Publik dhe Kontratat Konkensionare.
7. Auditimi i Performancës në KLSH.
8. Forcimi i kapaciteteve të auditimit të jashtëm në Shqipëri. (Shqip-Anglisht)

### **3- Transferta korrente dhe të huaja. Llogaria 605**

Gjatë periudhës raportuese janar-shtator 2016, janë shlyer detyrimet për kuota anëtarësimi për organizatat INTOSAI dhe EUROSAI, në shumën 127 mijë lekë nga 150, mijë lekë të planifikuara.

### **4- Transferta për buxhetet familjare. Llogaria 606**

Gjatë periudhës janar-shtator 2016, është dhënë Fond i Veçantë me kërkesat e bëra nga ana jonë dhe të konfirmuara nga Ministria e Financave në vlerën 295,4 mijë lekë, për daljen e punonjësve në pension, rast fatkeqësie dhe sëmundjeje dhe është realizuar në masën 295,4 mijë lekë ose 100% të planifikimit.

## 5- Shpenzime për investime kapitale. Llogaria 231

Bazuar në Ligjin nr. 147/2015, datë 17.12.2015 ÷Për buxhetin e vitit 2016, plani i buxhetit me destinacion Investimet Kapitale ishte në shumën 184,000 mijë lekë nga të cilat 84,000 mijë lekë investime me Financim të Brendshëm dhe 100,000 mijë lekë Investime me Financim të Huaj .Me Aktin Normativ nr. 1, datë 29.07.2016, ÷Për disa ndryshime ne ligjin nr. 147/2015 ÷Për buxhetin e vitit 2016, u bënë ndryshime në zërin Investime me Financim të Brendshëm duke zbritur vlerën prej 9,000 mijë lekë.

Tabela në vijim paraqet realizimin e buxhetit të Investimeve për vitin 2016, i detajuar sipas zërave.

### Shpenzime për Investime Kapitale

#### 1-Financim i Brendshëm

/000 Lekë

Emertimi i Projektit / Financim i Brendshëm	Plani sipas Ligjit	Plani i ndryshuar	Fakti	Diferenca	Statusi Projektit
Informatizimi i sistemit te menaxhimit te auditimit	41.000	41.000	0	41.000	Në proces prokurimi
Pajisje kompjuterike	1.000	1.000	0	1.000	Në proces prokurimi
Pajisje te ndryshme zyre	1.400	1.400	50	1.350	Në zbatim kontrate
Ndërtim Objekti "Ndërtim godina nr 2"	29.700	20.700	0	20.700	Në pritje të marrjes së lejes së ndërtimit
Projektimi i objektit "Ndërtim godina nr 2"	4.000	4.000	0	4.000	Në zbatim kontrate
Kosto lokale projekti IPA	6.900	6.900	0	6.900	Në proces implementimi
<b>Totali</b>	<b>84.000</b>	<b>75.000</b>	<b>50</b>	<b>74.950</b>	

#### 2-Financim i Huaj

/000 Lekë

Emertimi i Projektit /Financim i Huaj	Plani sipas Ligjit	Plani i ndryshuar	Fakti	Diferenca	Statusi Projektit
Projekti IPA -Forcimi i kapaciteteve te auditimit	100.000	100,000	40.641	59.359	Në proces implementimi
<b>Totali</b>	<b>100.000</b>	<b>100,000</b>	<b>40.641</b>	<b>59.359</b>	

### Investime me Financim të Huaj

Për vitin 2016, janë parashikuar fonde për realizimin e projekteve me Financim të Huaj në vlerën 100,000 mijë lekë dhe që i përket projektit IPA 2013 ÷Focimi i kapaciteteve të auditimit të jashtëm. Zbatimi i projektit IPA2013, i cili e përkufizon KLSH-në si në institucion modern evropian i auditimit suprem publik, i cili e bazon tërësisht aktivitetin e tij në standartet INTOSAI-t. Në mars 2016 ka filluar implementimi i projektit të binjakëzimit në KLSH. Gjatë periudhës mars-shtator 2016 janë implementuar 20 misione, të cilat lidhen me implementimin e kornizës legjislative për auditimin, zhvillimin e metodologjive të auditimit dhe kapaciteteve audituese si dhe forcimin e kapaciteteve institucional të KLSH dhe përmirësimin e impaktit të rezultateve të auditimit. KLSH nëpërmjet përfshirjes së të gjithë strukturave të tij, mbetet e angazhuar për implementimin e suksesshëm të këtij projekti, i cili synon modernizimin e institucionit. Misionet e realizuar për periudhën janar-shtator 2016, të projektit IPA 2013, paraqiten si më poshtë vijon:

-Ndryshimi i planifikimit ne menaxhim

-Rishikimi i situatës aktuale të burimeve njerëzore ne KLSH dhe hartimi i përmbajtjes se politikave njerëzore.

-Rishikimi dhe përditësimi i manualit të auditimit të performancës.

-Analiza e kuadrit rregullator të KLSH kundrejt deklaratës se Limës dhe standardeve te INTOSAIT.

-Rishikimi i sistemit te antikorrupsionit dhe mashttrimit ne Shqipëri dhe arritjet e KLSH ne fushën e zbulimit të korrupsionit dhe mashttrimit.

- Shqyrtimi i strukturës aktuale të KLSH.
- Rishikimi dhe përditësimi i Manualit të Auditimit të Performances.
- Zhvillimi i Manualit të Auditimit të IT i KLSH.
- Modulet standard të trajnimit për auditimin IT për audituesit e KLSH.
- Shqyrtimi i komunikimit të KLSH, përcaktimi i qëllimeve, objektivave dhe mjeteve për strategjinë e komunikimit të KLSH.
- Zhvillimi i metodologjisë për kontrollin dhe sigurimin e cilësisë.
- Draftimi i politikave dhe udhëzuesve përkatës për burimet njerëzore .
- Hartimi i rekomandimeve se si të aplikohet Ligji i ri i KLSH
- Misioni i dytë për ndryshimet e planifikimit në menaxhim
- Trajnimi për aktivitetet e luftës kundër korrupsionit dhe mashtrimit
- Hartimi i metodologjisë për kontrollin dhe sigurimin e cilësisë
- Shqyrtimi i dy auditimeve financiare dhe të përputhshmërisë në institucionet qendrore, ku përfshihen përgjigjet për gjetjet dhe rekomandimet.
- Rishikimi i rregullores së brendshme referuar amendimeve të ligjit për KLSH, qasjet e reja për auditimin financiar, të performancës dhe të përputhshmërisë
- Hartimi dhe paraqitja e qasjes bazuar në risk për auditimet financiare dhe të përputhshmërisë si dhe planifikimi strategjik i auditimeve
- Misioni i tretë për hartimin e metodologjisë për kontrollin dhe sigurimin e cilësisë

**Raporti i Monitorimit janar-shtator viti 2016**  
**Raporti i Shpenzimeve Faktike të Programit sipas Artikujve**

000/Lekë

Grupi	24	Kodi	1024001				
Programi	Veprimtaria Audituese e K.L.Sh.		Titulli	01120			
		Totali Shpenzimeve					
		(1)	(2)	(3)	(4)	(5)=(2)-(4)	
Artikulli	Emri	MTBP Plan 2016	Buxheti 2016	Buxheti i i Rishikuar 2016	Fakti 9/mujori 2016	Diferenca 2016	
Kodi	Emri						
600	Paga	229.000	229.000	229.000	163.042	65.958	
601	Sigurime Shoqërore	32.000	32.000	32.000	23.795	8.205	
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	87.000	87.000	87.000	45.446	41.554	
603	Subvencione					0	
604	Transferta Korente të Brendshme					0	
605	Transferta Korente të Huaja	150	150	150	127	23	
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	295	295	295	295	0	
<b>Nen-Totali</b>	<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>348.445</b>	<b>348.445</b>	<b>348.445</b>	<b>232.705</b>	<b>115.740</b>	
230	Kapitale të Patrupëzuara	100.000	100.000	100.000	40,641	59.359	
231	Kapitale të Trupëzuara	84.000	84.000	75.000	50	83.950	
232	Transferta Kapitale					0	
<b>Nen -Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>184.000</b>	<b>184.000</b>	<b>175.000</b>	<b>40.691</b>	<b>143.309</b>	
						0	
<b>Totali</b>	<b>KORRENTE DHE KAPITALE</b>	<b>532.445</b>	<b>532.445</b>	<b>523.445</b>	<b>273.396</b>	<b>259,049</b>	
<b>Jashte Buxhetore</b>		<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	
<b>Totali (korrente + kapitale + jashte buxhetore)</b>		<b>532.445</b>	<b>532.445</b>	<b>523.445</b>	<b>273.396</b>	<b>259,049</b>	
<b>Nepunesi Zbatues</b>	Emri	Alketa Kalleshi		Sekretari Pergjithshem	Emri	Luljeta	Nano
	Firma				Firma		
	Data	20/10/2016			Data	20/10/2016	

## Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve

000/Lekë

<b>Emri i Grupit</b>	<b>24 Kontrolli i Larte i Shtetit</b>			<b>Kodi i Grupit</b>	1024001		
		<b>Shpenzimet e Institucionit</b>					
<b>Programet</b>		<b>PBA 2016</b>	<b>Buxheti i Rishikuar 2016</b>	<b>Fakti 9 mujori 2016</b>	<b>Diferenca 2016</b>		
<b>Titulli</b>	<b>Emri</b>						
01120	Programi Veprimtari Audituese e KLSH	532.295	523.445	232.755	290.690		
<b>Totali i Shpenzimeve te Ministrise/Inst. Buxhetor</b>		<b>532.295</b>	<b>523.445</b>	<b>232.755</b>	<b>290.690</b>		
<b>Nepunesi Zbatues</b>	<b>Emri</b>	<b>Alketa</b>	<b>Kallesi</b>	<b>Sekretari i Përgjithshëm</b>	<b>Emri</b>	<b>Luljeta</b>	<b>Nano</b>
	Firma				Firma		
	Data	20/10/2016			Data	20/10/2016	

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**